



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 8180/2 prot.

Tiranë, më 27.102022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 8180/2, datë 27.10 2022

**"MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE,
KESH SH.A"**

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.317, datë 27.04.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.456, datë 29.06.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", pas shqyrtimit të propozimit të administratorit me shkresën nr.5119/2prot., datë 26.10.2022 dhe vendimit nr.12, datë 20.10.2022 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e rregullores së tregtimit të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, "KESH" sh.a, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "KESH" sh.a,

VENDOSA:

1. Miratimin e vendimit nr.12, datë 20.10.2022 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e rregullores së tregtimit të energjisë elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, "KESH" sh.a.
2. Shfuqizimin e rregullores në fuqi, miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.5233/1, datë 12.06.2019 "Për miratimin në parim të Rregullave të Përgjithshme të Organizimit të Aktivitetit Tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Kesh sh.a.

3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “KESH” sh.a për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku

A large, stylized handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKAT E ALBANIË" at the top, "MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the perimeter, and "TIRANË" at the bottom. The signature is written in a cursive, flowing style.



RREGULLORE E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

NGA

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SH.A.

MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

(Vendimi Nr. 8180/2, datë 27/10/2022)

Korrik 2022

PËRMBAJTJA

OBJEKTI DHE QËLLIMI	3
PËRCAKTIME	3
PARIMET E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	4
REGJISTRIMI I PJESMARRËSVE NË PROCEDURËN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	4
TREGTIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	5
ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË TREGTIMIT	6
NENI 8.....	6
FTESA PËR OFERTË	6
VLERËSIMI I OFERTAVE	7
ANULIMI I PROCEDURËS SË TREGTIMIT	7
SQARIMI DHE KORRIGJIMI I OFERTAVE	7
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS	7
DEKLARATA E KONFLIKTIT TE INTERESAVE	8
ANKIMI	8
MONITORIMI I PROCEDURAVE TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	8
SANKSIONE	8
NDRYSHIMET E RREGULLORES	8
HYRJA NE FUQI	8

**Neni 1
Baza Ligjore**

Këto rregulla hartohen në zbatim të pikës 3, të nenit 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të liçencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar.

**Neni 2
Objekti dhe Qëllimi**

- 2.1** Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla dhe procedura standarde të tregtimit të energjisë elektrike nga KESH.
- 2.2** Qëllimi i kësaj rregulloreje është:
- a) të zhvillojë procedura të thjeshtëzuara, efçente dhe praktike të tregtimit të energjisë elektrike;
 - b) të nxisë pjesëmarrjen e subjekteve të liçencuara në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike;
 - c) të nxisë konkurrencën në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike;
 - d) të garantojë transparencë, barazi, besueshmëri, konfidencialitet dhe mjedis konkurrues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike.

**Neni 3
Përcaktime**

Në këtë rregullore, termat e përdorur me poshtë do të kenë kuptimin:

- 3.1 KESH:** do të thotë shoqëria Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.
- 3.2 Autoriteti Kontraktues (AK):** do të thotë KESH-sh.a. si subjekt i liçencuar nga Enti Rregullator i Energjisë për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.
- 3.3 Subjekt i liçencuar:** do të thotë pala tjetër (counterparty) në një marrëdhënie tregtare me KESH, i liçencuar për tregtimin e energjisë elektrike dhe që ushtron aktivitetin e saj brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 3.4 Titullari i Autoritetit Kontraktues** do të thotë Administratori i KESH, ose personi i autorizuar prej tij në mënyrë të dokumentuar.
- 3.5 Njësia e Administrimit të Prodhimit (NJAP):** do të thotë njësia e parashikuar në strukturën organizative të shoqërisë si përgjegjëse, ndër të tjera, për operimin/shfrytëzimin e njësive gjeneruese në përgjegjësi administrimi të shoqërisë.
- 3.6 Njësia e Tregtimit të Energjisë Elektrike (NJTEE):** do të thotë njësia e parashikuar në strukturën organizative të shoqërisë si përgjegjëse, për zhvillimin e procedurës së tregtimit të energjisë elektrike dhe administrimit të kontratave të shitjes/blerjes së energjisë elektrike dhe/ose shërbimeve në tregun e energjisë elektrike.
- 3.7 Tregtim i energjisë elektrike:** do të thotë kalimi i ndërsjellë, në formën e shitjes ose blerjes në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike, nga shitësi tek blerësi, sipas pagesës dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratën përkatëse të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike dhe në legjislacionin në fuqi në RSH.
- 3.8 Procedurë tregtimi e energjisë elektrike:** do të thotë tërësia e veprimeve të kryera nga KESH për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike nga subjektet e liçencuara.
- 3.9 Periudhë tregtimi e energjisë elektrike:** do të thotë kohështrirja në të cilën shitet/blihet energjia elektrike dhe që mund të jetë me profil orar/blloqe orare ose në profilin band, për periudha afatshkurtra ose afatgjata.
- 3.10 Periudhë afatshkurtër:** do të thotë shitja dhe/ose blerja e energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë (Intraday), në ditën në avancë (Day Ahead) ose për një periudhë jo më shumë 92 (nëntëdhjetë e dy) ditë kalendarike pa ndërprerje.
- 3.11 Periudhë afatgjatë:** do te thotë shitja dhe/ose blerja e energjisë elektrike për një periudhë më shumë se 92 (nëntëdhjetë e dy) ditë kalendarike pa ndërprerje.

- 3.12 Pjesëmarrës i regjistruar:** do të thotë një subjekt i liçencuar që plotëson kushtet dhe kriteret për regjistrimin, i cili është kualifikuar dhe regjistruar nga KESH në regjistrin pjesëmarrësve në procedurat për shitjen/blerjen e energjisë elektrike.
- 3.13 Produkt tregtimi:** do të thotë energjia elektrike e propozuar për tregtim dhe e përcaktuar në kapacitet, sasi, periudhë lëvrimi, profil, etj..
- 3.14 Regjistri i pjesëmarrësve në procedurën e tregtimit të energjisë elektrike:** do të thotë një regjistër ku reflektohen të dhënat e parashikuara nga KESH për të gjithë pjesëmarrësit e kualifikuar për pjesëmarrje në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike që zhvillohen nga KESH referuar parashikimeve në këtë rregullore.
- 3.15 Ftesa për ofertë:** dokumenti zyrtar me anë të të cilit Autoriteti Kontraktues iu drejtohet pjesëmarrësve të regjistruar dhe që publikohet detyrimisht në faqen elektronike të Autoritetit Kontraktues.
- 3.16 Ofertë:** do të thotë tërësia e dokumenteve, të dërguar me postë elektronike (e-mail) me anë të së cilës një pjesëmarrës i regjistruar i përgjigjet kërkesës/ftesës për ofertë të dërguar si edhe të publikuar nga Autoriteti Kontraktues në faqen zyrtare të internetit.
- 3.17 Ofertues:** do të thotë pjesëmarrësi në procedurën e shitjes/blerjes së energjisë elektrike që paraqet një ofertë.
- 3.18 Kushte të përgjithshme tregtare:** do të thotë tërësia e elementëve/kushteve në përmbajtje të marrëveshjes/kontratë tip të shit-blerjes së energjisë elektrike që nënshkruhet nga subjektet e liçencuara gjatë procesit të regjistrimit në regjistrin e subjekteve të liçencuar të kualifikuar për pjesëmarrje në procedurat që zhvillohen nga KESH për shitjen/blerjen e energjisë elektrike.
- 3.19 Kushte të veçanta tregtare:** do të thotë elementët/kushtet e veçantë (çmimi, kapaciteti, sasia, profili i shitjes/blerjes së energjisë elektrike, modalitetet e pagesës etj.) në përmbajtje të njoftimit të fituesit dhe që konsiderohen pjesë e kontratës për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike të nënshkruar ndërmjet KESH dhe pjesëmarrësit të regjistruar.
- 3.20 Urdhërat për zhvillimin e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike:** janë aktet e Titullarit të Autoritetit Kontraktues që përcaktojnë të dhëna të karakterit tekniko-ekonomik të procedurës së shitjes/blerjes si dhe komisionin që do të kryejë këto procedura.
- 3.21 Komisioni i zhvillimit të procedurës:** sipas rastit, Komisioni i Blerjes ose Komisioni i Shitjes që përbëhet nga 3 persona ose me shumë, në numër tek, të caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktues me detyrën e zhvillimit të procedurës së shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike në përputhje me parashikimet në këtë rregullore.
- 3.22 Kapacitetet e transmetimit/interkonjeksionit:** janë kapacitetet e interkonjeksionit të cilat sigurohen nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose Pjesëmarrësi i Regjistruar, për të mundësuar shitjen/blerjen e energjisë elektrike.
- 3.23 Kodet teknike të aplikueshme:** do të thotë të gjithë Kodet e Rrjetit, të miratuar nga Bordi i ERE-s.
- 3.24 Proces Optimizimi:** do të thotë shitje dhe blerje e energjisë elektrike gjatë vitit kalendarik, ku në fund të vitit, bilanci financiar dhe/ose energjetik rezulton pozitiv.
- 3.25 EFET:** do të thotë European Federation of Energy Traders.

Neni 4

Parimet e Zhvillimit të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike

- 4.1** Procedurat e tregtimit të energjisë elektrike sipas kësaj rregulloreje do të realizohen në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe parimet e ruajtjes së konfidencialitetit.
- 4.2** Tregtimi i energjisë elektrike duhet të synojë përdorimin me efikasitet të të ardhurave, optimizimin e portofolit të KESH me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik.

Neni 5

Regjistrimi i Pjesëmarrësve në Procedurën e Tregtimit të Energjisë Elektrike

- 5.1** Çdo subjekt i liçencuar që dëshiron të regjistrohet në regjistrin e pjesëmarrësve në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike, së bashku me formularin e plotësuar sipas formatit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues si kusht për regjistrimin si pjesëmarrës në procedurat e tregtimit të energjisë elektrike, duhet

të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues edhe dokumentacionin e nevojshëm administrativ që vërteton personalitetin juridik dhe zotësinë ligjore për pjesëmarrje në procedura të tregtimit të energjisë elektrike, nga institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku është regjistruar dhe ushtron aktivitetin apo ka selinë e tij qendrore si dhe nga institucionet e shtetit shqiptar si më poshtë vijon:

- a. Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtarë dhe/ose ekstraktin e plotë (historik) të regjistrit tregtar të shtetit përkatës në të cilin shoqëria është regjistruar.
- b. Liçencën për tregtimin/furnizimin e energjisë elektrike të lëshuar nga autoritete përgjegjëse.
- c. Dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës i cili vërteton se:
 - i. Tregtari nuk është në proces falimentimi;
 - ii. Tregtari nuk është i dënuar për shkelje penale;
 - iii. Nuk ka falimentuar dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;
 - iv. Pasqyrat financiare të shoqërisë, të dy viteve të fundit, të çertifikuara sipas rregullave të shtetit përkatës ku shoqëria ushtron aktivitetin.

- 5.2** Pas paraqitjes dhe vlerësimit si të rregullt të dokumentacionit të parashikuar në pikën 5.1, Autoriteti Kontraktues kualifikon subjektin e liçencuar i cili ka kërkuar pjesëmarrjen dhe harton, mban dhe rishikon regjistrin e pjesëmarrësve. Në çdo kohë, pjesëmarrësi i regjistruar mund t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues pranimin e largimit dhe për pasojë heqjen e tij nga lista e pjesëmarrësve të regjistruar.
- 5.3** Dokumentacioni sipas pikës 5.1 do të përtërihet kryesisht, nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar, brenda muajit Dhjetor të çdo viti, dhe do të jetë i vlefshëm për vitin pasardhës. Mos dërgimi i dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar passjell çregjistrimin e pjesëmarrësit të liçencuar nga regjistri i Autoritetit Kontraktues.
- 5.4** Pas përfshirjes në regjistrin e pjesëmarrësve, Autoriteti Kontraktues, në të gjitha procedurat e zhvilluara nga ana e tij, u dërgon ftesë/ofertë pjesëmarrësve të regjistruar.

Neni 6

Tregtimi i Energjisë Elektrike

- 6.1** Përpara hapjes së një procedure tregtimi të energjisë elektrike, NJTEE merr në analizë:
- a. Detyrimet e korporatës të përcaktuara sipas akteve ligjore përkatëse mbi detyrimet për shërbim publik;
 - b. Të drejtat dhe detyrimet kontraktuale të korporatës ndaj palëve të treta jo publike;
 - c. Raportin e NJAP-së mbi kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike, rezervën hidrike, vlerësimin e situatës hidrometeorologjike;
 - d. Të dhënat e tregut rajonal të energjisë elektrike.
- 6.2** NJTEE duhet të krijojë produkte sipas strategjisë tregtare të ndjekur në përputhje me praktikat më të mira të tregtimit të energjisë. NJTEE duhet të konsiderojë krijimin e produkteve që optimizojnë kostot e blerjes/shitjes në përputhje me rregullat e tregjeve kombëtare e ndërkombëtare të energjisë.
- 6.3** NJTEE pas formimit të produktit sipas parashikimeve në pikat 6.1 & 6.2, i propozon Titullarit të Autoritetit Kontraktues dhënien e miratimit për tregtimin e produktit të propozuar.
- 6.4** Në rastin e procedurave të tregtimit afatgjatë, përpara publikimit, titullari i Autoritetit, i propozon Këshillit Mbikëqyrës dhe më tej Asamblesë së Aksionarëve (Organet drejtuese), dhënien e miratimit për tregtimin e produktit të propozuar.
- 6.5** Në këtë rast, relacioni i përcjellë për kërkesën duhet të përmbajë detyrimisht edhe analizën për kontraktimin afatgjatë e cila do të përmbajë por pa u kufizuar në to, analizën e nevojës së produktit energjetik, përshkrimin e produktit energjetik, analizën e çmimit të pritshëm, analizën e efektit në programin ekonomik, analizën e financiare, analizën e riskut etj..
- 6.6** Titullari i Autoritetit Kontraktues apo Organet drejtuese, pasi marrin në konsideratë vlerësimet e kryera nga NJTEE, urdhërojnë fillimin e procedurës së tregtimit të energjisë elektrike për produktin e propozuar nga NJTEE.

Neni 7**Zhvillimi i Procedurës së Tregtimit**

- 7.1** Procedura e tregtimit të energjisë elektrike do të kryhet nëpërmjet platformës elektronike të kontraktuar nga KESH sh.a..
- a. Manuali i përdorimit të saj i bashkëlidhet kësaj rregulloreje si (shtojca A).
- Në pamundësi të përdorimit të platformës elektronike për shkaqe të forcës madhore, autoriteti kontraktor mund të përdorë postën elektronike. Posta elektronike do të përdoret vetëm për periudha afatshkurtra tregtimi dhe në kushte emergjence. Procedurat e zhvilluara nëpërmjet postës elektronike duhet të garantojnë zhvillimin e procedurës mbështetur në parimet e barazisë, konfidencialitetit dhe anonimitetit.
- b. Manuali i procedurës së emergjencës me postë elektronike sipas manualit bashkëlidhur (shtojca B).
- 7.2** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës u dërgon (nëpërmjet platformës elektronike ose postës elektronike) ftesën për ofertë të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar.
- 7.3** Autoriteti Kontraktues do të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit ftesën për tregtimin e energjisë elektrike duke specifikuar qartazi produktin e kërkuar/ofruar si dhe kushtet e veçanta të ftesës për ofertë.
- 7.4** Brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë, Komisioni i Zhvillimit të Procedurës do të pranojë ofertat e pjesëmarrësve të regjistruar. Komisioni do të shpallë fituese ofertën që plotëson kushtet e përcaktuara në ftesën për ofertë. Komisioni i Zhvillimit të Procedurës do të zbatojë të njëjtën procedurë edhe në kushtet e paraqitjes së vetëm një oferte.
- 7.5** Çdo ofertë, e cila nuk është në përputhje me parashikimet dhe kërkesat e ftesës për ofertë të dërguar nga Autoriteti Kontraktues, do të konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni i Zhvillimit të Procedurës.
- 7.6** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës në rastin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike mund të pranojë sasi më të mëdha se sa sasia e kërkuar në ftesën për ofertë, por jo më shumë se 20 % (njëzetë) të sasisë së kërkuar në ftesë. Këto raste do të aplikohen pas analizimit të nevojës për blerje të energjisë, produktit të kërkuar sipas strategjisë tregtare, analizës së çmimit krahasuar me bursat e referencës, kostove të kapaciteteve, etj..
- Komisioni, në çdo rast, duhet të argumentojë në raportin përmbledhës arsyet e pranimit të sasive ndryshe nga ftesa për ofertë.
- 7.7** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës, në përfundim të procedurës së vlerësimit, përgatit raportin përmbledhës të procedurës i cili miratohet nga Titullari i Autoritetit Kontraktues. Vendimi u njoftohet fituesve në mënyrat e parashikuara në këtë rregullore.
- 7.8** Procedurat e zhvilluara për tregtimin e produkteve të energjisë elektrike në periudha afatshkurtra tregtimi zhvillohen brenda afateve kohore që gjykohen të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.
- 7.9** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës ka përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha ofertave të marra nga pjesëmarrësit e regjistruar.
- 7.10** Nëse pjesëmarrësi i regjistruar, tërhiqet përpara mbarimit të vlefshmërisë së ofertës, Autoriteti Kontraktues, nëse e vlerëson të arsyeshme, procedon me shpalljen fitues të ofertuesit të radhës.
- 7.11** Ndaj pjesëmarrësit zbatohen sanksionet e përcaktuara në kushtet e përgjithshme të kontratës.
- 7.12** Dokumentacioni së bashku me kontratën e lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar të shpallur fitues, regjistrohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8**Ftesa për Ofertë**

- 8.1** Ftesa për ofertë përmban të paktën elementët e mëposhtëm:
- Sasinë e energjisë elektrike në MWh që do të tregtohet;
 - Grafikun e lëvrimit;
 - Periudhën e lëvrimit në orë-bloqe orare/ditë/javë/muaj/vit;
 - Siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
 - Pikën e lëvrimit të energjisë elektrike;

- f) Kriterin e vlerësimit të ofertave;
- g) Afatin, mënyrën e dorëzimit të ofertave;
- h) Vlefshmërinë e ofertave;
- i) Kushtet e pagesave.

8.2 Në çdo rast, Autoriteti Kontraktues mund të parashikojë edhe kërkesa dhe/ose kushte të tjera, të cilat duhet të jenë në funksion të së mirës publike, të arsyeshme, jo-diskriminuese, në funksion të procedurës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Vlerësimi i Ofertave

- 9.1** Kriteri i vetëm i vlerësimit të ofertave, do të jetë çmimi/njësi dhe/ose çmimet/njësi më të larta të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së shitjes së energjisë elektrike dhe çmimi/njësi dhe/ose çmimet/njësi më të ulëta, të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së blerjes së energjisë elektrike.
- 9.2** Në rastin kur ofertat kanë të njëjtin çmim/njësi, do të zbatohet parimi i ndarjes proporcionale.
- 9.3** Në të gjitha rastet e aplikimit të procedurave të shitjes dhe/ose të blerjes, Autoriteti Kontraktues nuk përlogarit çmim/njësi minimal fillestar.

Neni 10

Anulimi i Procedurës së Tregtimit

Autoriteti Kontraktues, në çdo rast, mund të anulojë procedurën e tregtimit të energjisë elektrike për një nga arsytet e mëposhtme:

- a) nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore të paraqitjes së tyre;
- b) asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret dhe/ose kushtet tekniko-ekonomike, të përcaktuara në ftesën për ofertë;
- c) të gjitha ofertat e pranura përmbajnë çmime/njësi apo vlera që nuk justifikojnë qëllimin për të cilin është realizuar procedura;
- d) për arsye të tjera të vërtetueshme, jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues dhe të paparashikueshme prej tij në kohën e njoftimit apo zhvillimit të procedurës së tregtimit të energjisë elektrike në emër të interesit të Korporatës dhe atij publik.

Neni 11

Sqarimi dhe Korigjimi i Ofertave

- 11.1** Për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejte të ofertave të paraqitura nga ofertuesit, Komisioni i Zhvillimit të Procedurës, kur e gjykon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime ose informacion lidhur me to.
- 11.2** Autoriteti Kontraktues korigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi nuk ndikon drejtpërsëdrejti në kushtet dhe kriteret thelbësore të ofertës.

Neni 12

Komisioni i Zhvillimit të Procedurës

- 12.1** Komisioni i Zhvillimit të Procedurës përbëhet nga 3 ose më shumë anëtarë, në numër tek, dhe nga ku njëri nga anëtarët kryen funksionin e kryetarit.
- 12.2** Në përbërje të Komisionit të Zhvillimit të Procedurës duhet të ketë së paku 1 (një) anëtar me profesion jurist dhe 1 (një) anëtar me profesion ekonomist.
- 12.3** Titullari i NJTEE në çdo rast është kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Procedurës. Në mungesë të drejtuesit të NJTEE, vendin e kryetarit e zë punonjësi me eksperiencën me të gjatë në NJTEE, kjo procedurë ndiqet deri në plotësimin e vendit të kryetarit.
- 12.4** Përbërja e Komisionit të Zhvillimit të Procedurës caktohet nga Titullari i Autoritetit Kontraktues në urdhërin për zhvillimin e procedurës së tregtimit.
- 12.5** Titullari i Autoritetit Kontraktues përcakton anëtarët e komisionit zëvendësues në rast të mungesës së anëtarëve të përhershëm.

Neni 13

Deklarata e Konfliktit të Interesave

Çdo anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Procedurës do të nënshkruajë deklaratën me anë të së cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me pjesëmarrësit e regjistruar në KESH sh.a, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave. Nëse një nga anëtarët e Komisionit është në kushtet e konfliktit të interesave me një nga pjesëmarrësit e regjistruar në KESH-sh.a., atëherë Kryetari i Komisionit do t'i kërkojë Titullarit të Autoritetit Kontraktues zëvendësimin e tij.

Neni 14

Ankimi

- 14.1** Çdo ofertues mund të ankohet për rezultatet e procedurës së tregtimit të energjisë elektrike për ngjarje të konstatuara pas njoftimit/publikimit të rezultatit por jo më vonë se 24 orë nga shpallja e rezultatit. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e pjesëmarrësit, referimin për procedurën, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar. Ankimi për rezultatet e procedurës nuk pezullon procesin pasi kjo do të nënkuptonte humbjen e vlefshmërisë së ofertave për ofertuesit e tjerë.
- 14.2** Titullari i Autoritetit Kontraktues, pasi krijon grupin e punës për shqyrtimin e ankesës nxjerr vendim të arsyetuar lidhur me ankesën, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e ankesës.
- 14.3** Anëtarët e grupit të punës që do të shqyrtojnë ankesën e operatorit nuk duhet të jenë pjesë e NJTEE.
- 14.4** Pjesëmarrësi gëzon të drejtën e kundërshtimit në gjykatë Gjykatë të Vendimeve të Autoritetit Kontraktues.

Neni 15

Monitorimi i Procedurave të Tregtimit të Energjisë Elektrike

- 15.1** Procedurat e tregtimit të energjisë elektrike ruhen në platformën e tregtimit të energjisë elektrike. Raporti përmbledhës depozitohet në formë të printuar në protokollin e KESH-sh.a..
- 15.2** Autoriteti Kontraktues i paraqet Këshillit Mbikëqyrës të KESH-sh.a., jo më vonë se data 15, një raport analitik mbi procedurat e tregtimit të energjisë elektrike të zhvilluara në muajin paraardhës.
- 15.3** Autoriteti Kontraktues ka detyrimin t'i japë në mënyrë transparente çdo institucioni të ngarkuar me ligj të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij, për tregtimin e energjisë elektrike.

Neni 16

Sanksione

Për shkeljen e këtyre rregullave, kur nuk përbën vepër penale ose kundërvajtje administrative, organet drejtuese të KESH zbatojnë parashikimet e akteve të tjera që rregullojnë aktivitetin e KESH.

Neni 17

Ndryshimet e rregullores

- 17.1** Ndryshimet në përmbajtjen e kësaj rregulloreje bëhen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të KESH-sh.a..
- 17.2** Për çështje të cilat nuk parashikohen në këtë rregullore por evidentohen gjatë zbatimit të saj, ngarkohet Administratori i shoqërisë që të veprojë kryesisht, në zbatim të parimeve të kësaj rregulloreje dhe parimeve bazë të legjislacionit civil dhe atij të procedurave administrative.

Neni 18

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.